



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 tetor 2020
Nr. ref.:RK 1622/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI01/19

Parashtrues

Fatos Rizvanolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. Nr. 242/2017, i 30 prillit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fatos Rizvanolli (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga avokati Besnik Berisha nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.Nr.242/2017, të 30 prillit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. Nr. 100/2017, të 23 majit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR-65/16, të 18 janarit 2017.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme [PML.Nr.242/2017], i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 shtator 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, për të cilët pretendohet se kanë shkelur nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33.1 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 7 (Nuk ka dënim pa ligj) dhe 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 4 janar 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 9 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 14 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe iu kërkua që të dorëzojë dëshmi për ditën e pranimit të vendimit të kontestuar. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 3 shkurt 2020, Gjykata kërkoi dosjen e lëndës nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Më 5 shkurt 2020, Gjykata Themelore në Ferizaj dorëzoi dosjen lëndës në Gjykatë.

10. Më 1 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Bekim Sejdiu dhe, me shumicë votash, votoi kundër propozimit të Gjyqtarit raportues për ta shpallur kërkesën të pranueshme dhe për shqyrtim të çështjes në merita.
11. Në të njëjtën ditë, Gjyqtari raportues në bazë të rregullit 58 (4) [Këshillimet dhe Votimi] të Rregullores së punës kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktvendimin për papranueshmëri.
12. Në të njëjtën ditë, në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Radomir Laban, si njërin nga gjyqtarët e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktvendimin për papranueshmëri.
13. Më 2 shtator 2020, Gjyqtari Radomir Laban prezantoi Aktvendimin për papranueshmëri para Gjykatës.

Përmbledhje e fakteve

A) PROCEDURAT PËR KUNDËRSHTIMIN E PROVAVE DHE HEDHJEN E AKTAKUZËS

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 10 prill 2014, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (më tutje: Prokuroria Speciale) kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë (S.T., I.B., Y.B., I.K., A.R., B.B., J.R., Sh.K., J.K., B.Sh., A.F., L.K., L.K., F.K., H. K., I.K., Z.Q.), për shkak të dyshimit të arsyeshëm që personat e lartpërmendur kishin kryer veprat penale: *Rekrutimi për terrorizëm*, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal të Kosovës; *Nxitja e urrejtjes, perçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik*, të parashikuar nga neni 147 i Kodit Penal të Kosovës; *Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*, të parashikuar nga neni 143, par. 2 i Kodit Penal të Kosovës; *Shtytja për kryerjen e veprave terroriste*, të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal të Kosovës.
15. Më 24 mars 2016, Prokuroria Speciale dorëzoi pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda (më tutje: Gjykata Themelore), Aktakuzën PPS. Nr. 39/2014, kundër parashtruesit të kërkesës, për veprën penale *Rekrutimi për terrorizëm në bashkëkryerje*, të parashikuar me nenin 139, lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Kosovës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte kundërshtuar pranimin e provave dhe kishte kërkuar hedhjen e aktakuzës, në Gjykatën Themelore.
17. Më 30 maj 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit PKR. Nr. 65/2016, refuzoi si të pabazuar kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të dorëzuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale (neni 384 par.1 pika 1.7 dhe 1.12 si dhe par.2 pika 2.1 të KPPK-së), si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar dhe të miratojë kundërshtimin ndaj provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.
19. Më 20 qershor 2016, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Pn. nr.454/16, refuzoi të pa themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore PKR. Nr. 65/2016, të 30 majit 2016.
20. Më 20 qershor 2016, Prokuroria Speciale, duke u mbështetur në nenet 240.1 dhe 252.5 të Kodit të Procedurës Penale Nr.04/L-123 (në tekstin e mëtejme: KPP), paraqiti në Gjykatën Themelore aktakuzën e ndryshuar kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale: *Rekrutim për terrorizëm në bashkëkryerje*, nga neni 139 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (me tutje: KPK). Me këtë aktakuzë, parashtruesi i kërkesës akuzohej për të njëjtën veprë penale por me një përshkrim më të zgjeruar.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte kundërshtuar pranimin e provave duke kërkuar hedhjen e aktakuzës së ndryshuar, në Gjykatën Themelore në Ferizaj.
22. Më 5 gusht 2016, Gjykata Themelore në Ferizaj, përmes Aktvendimit PKR. nr. 65/2016, refuzoi të pa themeltë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës.
23. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar dhe kundërshtimin ndaj provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës ta aprovojë.
24. Në ankesën e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar: “[...] aktvendimi i ankimuar është kundërthënës, i paqartë, i pa arsyetuar mirë dhe nuk është hartuar në përputhje me nenin 370 par.7 të KPPK-së, pasi që të gjitha provat e bashkangjitura në mbështetje të aktakuzës nuk e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi të ketë bërë thirrje apo të ketë inkurajuar ndonjë person tjetër që të bëhet anëtarë-anëtarësohet në grupin terrorist ISIS, që të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste apo aktivitetit të grupit terrorist, andaj në mungesë të provave që mbështesin dyshimin e bazuar mirë dhe për shkak të papërshtatshmërisë ligjore dhe papranueshmërisë së provave si: memorandumi zyrtarë Nr.Ref.06/1-03/330/2016, i dt.24.05.2016, procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit IS, autorizimi nga Banka Ekonomike, Video incizimit të Aeroportit të Prishtinës, urdhëresës Retroaktive, mungesës së Urdhëresës për marrjen e video incizimit dhe transkripteve të komunikimeve në

mes Fatos Rizvanolli dhe LM dhe UGJK Nr.34/14, e dt.15.03.2016, Konfirmimit të Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, deklaratës së IB, njoftimi për ndërprerjen e marrëveshjes për qira dhe njoftimi për policinë e Kosovës nga N.SH "Auto Prishtina", mbrojtja konsideron se aktakuza kundër të mbrojturit të tij rezulton të jetë në kundërshtim me ligjin dhe pa prova të mjaftueshme për të proceduar më tutje”.

25. Më 25 gusht 2016, Gjykata e Apelit, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët H.H., D.M. dhe Xh.A., me Aktvendim PN. Nr. 609/16, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore Nr. 65/2016, të 5 gushtit 2016.
26. Gjykata e Apelit, mes tjerash, shpjegoi se: *“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Sepse, Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar për hedhjen e aktakuzës është kujdesur sipas thënieve nga kundërshtimet që të vlerësoj dhe në mënyrë të drejtë ka dhënë arsye të mjaftueshme se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa tani nuk ka argumente bindëse dhe që nuk përmbajnë asnjërën prej bazave ligjore për të cilën mund të hedhet aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 250 par. 1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPK-së [...] Gjykata e shkallës së parë ka dhënë në mënyrë të zgjeruar arsye lidhur me dyshimin e bazuar rreth provave të kundërshtuara dhe drejt ka vërtetuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme të pranueshme në aspektin ligjor-procedural, duke u bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës se nga veprimet e përshkruara në aktakuzë, tani ekzistojnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari [...] ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit tani janë të pabazuara që këto dëshmi të shpallen si prova të pranueshme, e që në esencë asnjëra prej tyre nuk përmban asnjë provë me të cilën do të vërtetohej e kundërta e aktakuzës, ashtu që edhe kërkesat mbi hedhjen e aktakuzës të kenë bazë ligjore”.*

B) RPOCEDURAT E SHQYRTIMIT GJYQËSOR DHE MJETIT JURIDIK

27. Nga shkresat e lëndës vërehet se në Gjykatën Themelore ishin mbajtur disa shqyrtime gjyqësore, përkatësisht në datat 08.04.2016, 14.04.2016, 04.07.2016, 11.10.2016, 04.11.2016, 25.11.2016, 21.12.2016, 22.12.2016, 29.12.2016 dhe 30.12.2016.
28. Ndërkohë, nga kërkesa e parashtruesit të kërkesës vërehet se më 29 dhjetor 2016, Prokuroria Speciale kishte ndryshuar përsëri aktakuzën, duke precizuar dispozitivin e saj dhe duke e ngarkuar parashtruesin e kërkesës edhe me veprën penale *“Pjesëmarrje në grupet terroriste”*, të parashikuar nga neni 113 i KPK-së, lidhur me nenin 23 paragrafin 2 të KPK-së.

29. Më 18 janar 2017, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin PKR-65/16, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe i shqiptoi atij dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh, për veprën penale “*në vazhdim dhe bashkëkryerje rekrutim për terrorizëm*”, nga neni 139, lidhur me nenin 31 të KPK-së. Në dënimin e shqiptuar, parashtruesit të kërkesës iu llogarit koha e kaluar në paraburgim, prej 16 marsit 2016.
30. Në këtë Aktgjykim, ndër të tjera, arsyetohej si në vijim: “*...në bazë të provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësorë u vërtetua se i akuzuari gjatë periudhës kohore prej vitit 2011-2014, në bashkë kryerje me tani të dënuarit ZQ e IB, u ka bërë thirrje personave të tjerë për të marrë pjesë në kryerjen e veprave terroriste dhe ka përkrahur aktivitetet terroriste të organizatës ISIS e Al Nusra, duke propaganduar dhe postuar në pajisjet elektronike-kompjuterët, fotografi me përmbajtje dhe thirrje për xhihad [...] me të gjitha provat e paraqitura dhe të vlerësuara është vërtetuar se i akuzuari gjatë periudhës kohore 2011-2014 me qëllim të përkrahjes dhe të lehtësimit të aktiviteteve terroriste për personat që kanë marrë pjesë në luftërat e Sirisë, si pjesëtarë të organizatave terroriste ISIS dhe Al Nusra, u ka ofruar fonde dhe burime materiale në lehtësimin e veprimeve të këtyre personave të cilët kanë marrë pjesë në këto organizata, kështu duke i vënë në dispozicion, përdorim dhe shfrytëzim veturat e tij me të cilat këta persona kanë udhëtuar dhe i kanë shfrytëzuar e që pastaj këta persona janë marrë me aktivitetet në këto organizata terroriste [...] I pandehuri Fatos Rizvanolli, është liruar nga akuza për pikën 2, 3 dhe 5 të aktakuzës për veprën penale të kryer në vazhdim dhe në bashkëkryerje organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet meqë nuk është provuar se i i pandehuri ka kryer këtë vepër penale”.*
31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa, kurse aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga akuza, apo ai të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
32. Më 23 maj 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR.nr.100/2017, refuzoi të pa themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR-65/16, të 18 janarit 2017.
33. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se: “[...] të gjitha fotografitë e postuara në pajisjet e tij elektronike-kompjuter dhe telefon, thirrjet për xhihad, pjesë të kuranit, fotografi të luftës në Siri që rezultojnë nga raporti njoftues-analizimi i ekzaminimeve të pajisjeve elektronike të të akzuarit me nr. ref 06/1-03/385-2016 datë 14.07.2016 shpijnë në të vetmin konkludim se i akuzuari në bashkëkryerje me tani të dënuarit ZQ dhe IB u ka bërë thirrje personave të tjerë për të marrë pjesë në kryerjen e veprave terroriste dhe ka përkrahur aktivitetet terroriste të organizatave "ISIS" e "AL Nusra " siç me të drejtë ka konkluduar

edhe gjykata e shkallës së parë. Pastaj, me vetë faktin se i akuzuari u ka vënë në dispozicion përdorim dhe shfrytëzim veturat e tij personave ShA, SH, ZQ, LM dhe IB, me të cilat këta persona kanë udhëtuar, e që këta persona janë marrë me aktivitetet të organizatave terroriste, e që vërtetohet se të gjitha veturat e dhëna me qira kanë qenë pronë e biznesit "Auto Market" në vitin 2014 dhe që më vonë kanë kaluar në pronësi të N.T.SH "Tosi", kurse bazuar në librat për regjistrimin e aktiviteteve biznesore të këtyre firmave del se janë evidentuar të gjitha veturat e dhëna me qira dhe shitblerja e veturave tjera por nuk është mbajtur evidencë për dhënien me qira të personave të lartcekur është më se e qartë se i akuzuari në veprimet e tij ka konsumuar edhe elementin tjetër të veprës penale - sigurimi i fondeve apo burimeve materiale personave që kanë marrë pjesë në luftërat e Sirisë si pjesëtar të organizatave terroriste (ISIS E AL NUSRA)".

34. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, duke pretenduar se ato janë karakterizuar me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kontestuara të ndryshohen, ashtu që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga akuza, ose të anulohen ato dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
35. Në mënyrë të përmbledhur, pretendimet dhe argumentet kryesore të paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ishin se *"Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Procedurës Penale, për shkak se Gjykata e Apelit ka dështuar që të japë arsye të qarta, logjike, ligjore dhe koherente mbi refuzimin e pretendimeve të parashtruara nga Mbrojtja, në ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, si dhe që të tregojë shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar në bazë të detyrës zyrtare. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit ka dështuar që të shtjellojë dhe të arsyetojë drejtë dhe saktë, shkaqet për të cilat është ushtruar Ankesë kundër Aktgjykimit, si dhe që të shtjellojë në mënyrë specifike dhe të saktë që nuk ka shkelje të nenit 394.1 të KPP, rrjedhimisht duke e përfshirë Aktgjykimin e saj në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale"*.
36. Më tutje në këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se në ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit, ai kishte argumentuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte mbështetur tërësisht mbi prova të papranueshme (duke i përmendur veç e veç secilën prej tyre).
37. Më 30 prill 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Pml.nr.242/2017, refuzoi të pathemeltë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit Gjykatës Themelore, PKR-65/16, të 18 janarit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.100/2017, të 23 majit 2017.
38. Gjykata Supreme arsyetoi se *"Aktgjykimi i shkallës së parë përmban arsye për faktet vendimtare dhe për atë se përse një fakt konsiderohet i vërtetuar apo i pavërtetuar. Në këtë aktgjykim është vlerësuar mbrojtja e të dënuarit dhe secila*

provë e administruar, veç e veç dhe ne lidhmëni njëra me tjetrën, siç kërkohet me dispozitën e nenit 361.par.2.te KPPK”.

39. Më tutje, Gjykata Supreme trajtoi, veç e veç, pretendimet dhe argumentet e ngritura nga i dënuari (parashtruesi i kërkesës), përkitazi me çështjet në vijim: a) nëse parashtruesi i kërkesës është pronar i firmës për qiradhënie të automjeteve “Tosi”, si dhe nëse përmes kësaj firme iu është ofruar mbështetje përmes dhënies në shërbim të automjeteve, personave të dyshuar apo dënuar për terrorizëm (ShA, SH, ZQ, LM dhe IB); b) nëse parashtruesi i kërkesës ka mundur udhëtimin për në Siri për personat PB, ShK, HD, KM dhe IB; c) nëse gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e vet e ka bazuar edhe në deklaratën e IB të dhënë jo vetëm në shqyrtimin gjyqësor por në polici; d) pranueshmërinë si provë të materialit me përmbajtje propagandistike për përkrahje të aktiviteteve terroriste të organizatave ISIS dhe Al Nusra; e) zgjerimin e aktakuzës nga Prokurori Shtetëror; f) pranueshmëria si prova e urdhëresave gjyqësore për zbatimin e masave të fshehta; h) konfiskimin e gjësendeve të parashtruesit të kërkesës; i) zbatimi i gabuar i ligjit penal lidhur me dënimin e parashtruesit të kërkesës. Në ndërlidhje me këto pretendime të ngritura me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme nuk konstatoi asnjë shkelje nga gjykatat e shkallës më të ulët.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33.1 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
41. Shkeljen e dispozitave kushtetuese të lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës e artikulon duke pretenduar shkelje: (i) të parimit për vendim të arsyetuar gjyqësor, shkelje të së drejtës së ankimit në kuptimin substancial, shkelje të parimit të çmuarjes së lirë të provave në procedurë penale, shkalla e parimit të paanshmërisë së gjykatës, shkelja e të drejtës për dëgjimin e dëshmitarëve lidhur me shkeljen e parmit të kontradiktoritetit; (ii) përdorimi i provave në mënyrë të kundërligjshme dhe në shkelje të të drejtave kushtetuese; (iii) shkelja e të drejtës së privatësisë; (iv) shkelja konsekuative e të drejtave të mbrojtjes, parimit të barazisë së armëve, si dhe të parimit *in dubio pro reo*, dhe; (v) shkelja e parimit të mos dënimit pa ligj.

Pretendimi për shkelje të të drejtës për vendim të arsyetuar

42. Për sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme: (i) ka shpërfillur plotësisht një numër të konsiderueshëm të shkeljeve thelbësore; (ii) ka dështuar të vlerësojë ligjshmërinë e pretendimeve duke mos dhënë asnjë përgjigje; (iii) ka shtrembëruar e kamufluar në mënyrë tërësisht arbitrare përmbajtjen e shkresave të lëndës, çka ka rezultuar në kundërrthënie të hapur mes arsyetimit të aktgjykimit dhe shkresave të lëndës; dhe, (iv) ka dështuar që në mënyrë logjike dhe koherente të lidhë rregullat e

zbatueshme me faktet e rastit, siç kërkohet me të drejtën për një vendim të arsyetuar.

43. Me qëllim të mbështetjes së pretendimit për një vendim të arsyetuar, Parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve KI72/12 dhe KI135/14 nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe disa rasteve nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, *Hiro Balani kundër Spanjës, Hirvisaari kundër Finlandës, Tatishvilli kundër Rusisë*, etj.

Pretendimi për shkelje të parimit të gjykatës së paanshme

44. Për sa i përket parimit për paanshmërinë e gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata e Apelit e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të Ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ka shkelur parimin e paanshmërisë, për shkak të kundërligjshmërisë së përbërjes së kolegjit shqyrtues, sepse kryetarja e kolegjit, gjyqtarja HH, si dhe gjyqtari referues DM, kishin marrë paraprakisht pjesë në të njëjtën procedurë penale, me rastin e konfirmimit të Aktakuzës kundër z. Fatos RIZVANOLLI me datë 25.08.2016, në po të njëjtat cilësi”*.
45. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon: *“Siç rezulton, gjyqtarja HH ka marrë pjesë dy herë në cilësinë e kryetares së kolegjit në të cilat janë shqyrtuar respektivisht ankesat kundër Aktvendimit për konfirmim të aktakuzës dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj. Në po të njëjtën mënyrë, edhe gjyqtari DM ka marrë pjesë dy herë në cilësinë e gjyqtarit referues dhe anëtarit, në kolegjet që kanë shqyrtuar ankesat kundër Aktvendimit për konfirmimin e Aktakuzës dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [...] Në rrethanat faktike të lartpërmendura rezulton se gjyqtarët HH dhe DM kanë shqyrtuar dhe zgjidhur në themel çështjen penale kundër z. Fatos RIZVANOLLI, duke manifestuar bindjen e tyre lidhur me fajësinë e tij”*.
46. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: *“Gjyqtarët HH dhe DM, konform nenit 39.2 të KPP duhet të kishin informuar ex officio Gjykatën e Apelit mbi domosdoshmërinë e përjashtimit të tyre nga përbërja e kolegjit shqyrtues të Ankesës së parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj, pikërisht për shkak të pjesëmarrjes së tyre në një fazë decitive të mëhershme në po të njëjtën çështje penale, kjo për shkak se Aktvendimi PN. Nr. 609/16, i datës 25.08.2016, përbënte shkresë zyrtare të përfshirë në dokumentet e lëndës”*.
47. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe një gjyqtare, MM, kishte gjykuar rastin e tij më parë, për çka ai thekson: *“Gjyqtarja MM së pari është përfshirë në çështjen penale kundër z. Fatos RIZVANOLLI me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit PN. Nr. 454/16, të datës 20.06.2016, me të cilin u refuzua si e pabazuar Ankesa e parashtruar nga mbrojtja e z. Fatos RIZVANOLLI kundër Aktvendimit të parë të Gjykatës Themelore lidhur me hedhjen e Aktakuzës dhe kundërshtimin ndaj provave [...] Edhe pse gjyqtarja MM nuk mori pjesë në shqyrtimin e Ankesës së lartpërmendur, në bazë të informatave të sigurta dhe të mbrojtura që disponon përfaqësuesi i autorizuar i z. Fatos RIZVANOLLI, në përputhje me Ligjin 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, rezulton se rasti*

konkret i z. Fatos RIZVANOLLI është trajtuar dhe vendosur nga një gjyqtare e vetme, saktësisht VETËM nga gjyqtarja MM, e cila ka përpiluar gjithashtu edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 100/2017, me të cilin u vërtetua Aktgjykimi fajësues i shpallur nga Gjykata Themelore në Ferizaj [...] pavarësisht pamundësisë tonë për të zbuluar identitetin e informatorit, për shkak të garancive substanciale të parashikuara nga legjislacioni i lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese mund të shfrytëzojë qasjen e saj direkte, duke siguruar informatat e nevojshme teknike se nga KUSH është hartuar Aktgjykimi PAKR. Nr. 100/2017, në CILIN kompjuter është përpiluar i njëjti, si dhe rrjedhimisht KUSH e ka trajtuar dhe vendosur de facto çështjen penale kundër z. Fatos RIZVANOLLI”.

48. Me qëllim të mbështetjes së pretendimit për shkelje të parimit për paanshmërinë e gjykatës, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit nr. KIO6/12 nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe disa rasteve nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, Kyprianou kundër Qipros, Piersack kundër Belgjikës, Grieves kundër Mbretërisë së Bashkuar, etj.

Pretendimi për shkelje të të drejtës për dëgjimin e dëshmitarëve ZQ dhe Sha

49. Për sa i përket të drejtës për dëgjimin e dëshmitarëve (parimi i kontradiktoritetit), parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës penale gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën kushtetuese të garantuar me nenin 31.4 të Kushtetutës, për shkak të refuzimit për të dëgjuar dëshmitarët ZQ dhe Sha.
50. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “E drejta kushtetuese e z. Fatos RIZVANOLLI për të thirrur dëshmitarët përkatës lidhur me faktet inkriminuese për të cilat ngarkohej, është shkelur sistematikisht në të gjithë stadet e procedurës penale kundër, përfshirë këtu procedurën paraprake, gjykimin në shkallë të parë, vendosjen sipas ankesës në shkallë të dytë, si dhe vendosjen sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik pranë Gjykatës Supreme të Kosovës”.
51. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “se refuzimi i gjykatës themelore për ta dëgjuar dëshmitarin ZQ është i kundërligjshëm sepse emri i dëshmitarit në fjalë është përmendur në aktakuzë si person me të cilin parashtruesi i kërkesës ka “bashkëpunuar në kryerjen e veprave penale”. Emri i dëshmitarit ZQ është i pranishëm edhe në pikë pikën I të dispozitivit të aktgjyimit të gjykatës themelore, i cili pranohet në tërësi edhe nga gjykata e apelit”.
52. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës vë në pah arsyetimin e gjykatës themelore për refuzim të dëgjimit të dëshmitarit ZQ: “...Refuzohet propozimi që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet ZQ meqë prania dhe dëgjimi i tij si dëshmitar nuk do të jetë objekt i çështjes penale dhe se veprimet e aktakuzës në këtë çështje nuk kanë ndonjë lidhje apo relevancë me veprimet e të akuzuarit”.

53. Parashtruesi i kërkesës po ashtu vë në pah pjesën relevante të aktakuzës (PPS nr. 39/2014) që ndërlidhet me dëshmitarin ZQ: “...me dashje me të pandehurit ZQ, IB dhe ST ka marrë pjesë në kryerjen e veprave terroriste dhe në aktivitetet e grupit terrorist...”. Parashtruesi i kërkesës shton: “Ky konstatim i Gjykatës Themelore, i cili në mënyrë të kundërligjshme dhe të palogjikshme pranohet nga Gjykata e Apelit dhe injorohet tërësisht nga Gjykata Supreme, bie në kundërshtim me përmbajtjen e aktakuzës PPS. nr. 39/2014, të dorëzuar me datë 20.06.2016, mbi bazën e së cilës është mbajtur shqyrtimi gjyqësor”.
54. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës përfundon: “Për këto arsye, arsyetimi i Gjykatës Themelore mbi refuzimin e propozimit për të thirrur në cilësinë e dëshmitarit ZQ, i cili mbështetet edhe nga Gjykata e Apelit, është arbitrar dhe cenon rëndë të drejtën e z. Fatos RIZVANOLLI për të thirrur dëshmitarë të cilët mund të zbardhin faktet, e drejtë e cila i garantohet nga neni 31.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
55. Kurse sa i përket refuzimit të gjykatës themelore për dëgjimin e dëshmitarit ShA, parashtruesi i kërkesës pretendon: “Në po të njëjtën mënyrë, edhe pse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës themelore, i cili pranohet në tërësi edhe nga gjykata e apelit, z. Fatos RIZVANOLLI ngarkohet me veprim inkriminues të vënies në dispozicion, më datë 17.10.2011, të automjetit tip “Toyota”, me targa 01-877-CF, në favor të personit ShA, gjykata themelore ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për ta thirrur z. ShA në cilësinë e dëshmitarit me arsyetimin se “prania e tij në gjykatë dhe sigurimi i tij që të dëshmojë drejtpërdrejtë në Gjykatë, është shumë i vështirësuar dhe i pamundur”, duke shtrembëruar kërkesën e mbrojtjes, pa dhënë as edhe një arsye të vetme se përse dëshmia e tij është e pamundur për t’u siguruar, si dhe pa kryer as edhe një përpjekje të vetme për ta thirrur z. ShA në cilësinë e dëshmitarit”.
56. Parashtruesi i kërkesës thekson se mbrojtja e tij nuk kishte kërkuar që dëshmitari ShA të dëshmojë duke qenë i pranishëm fizikisht por përmes videolinkut. Parashtruesi i kërkesës shton se refuzimi për dëgjimin e dëshmitarit ShA ishte arbitrar me ç’rast gjykata themelore ishte shprehur: “Prania e tij në Gjykatë dhe sigurimi i tij që të dëshmojë drejtpërdrejtë në Gjykatë është shumë i vështirësuar dhe i pamundur”.
57. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës pretendon: “Gjykata Themelore, edhe pse e dinte vendndodhjen e ShA, për shkak se posedonte një Raport Ekstradimi të tij në Maqedoni, nuk bëri as edhe një përpjekje të vetme për t’u vënë në kontakt me autoritetet maqedonase dhe për të siguruar dëshminë e tij përmes videolinkut, në kundërshtim të plotë [...] me garantitë procedurale të nenit 6.3 të KEDNJ”.
58. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton: “Refuzimi i Gjykatës Themelore ishte kategorik dhe i menjëhershëm, pa bërë as edhe përpjekjen me të vogël për t’u vënë së paku në kontakt me autoritetet maqedonase, si dhe për të kërkuar, nëpërmjet ndihmës juridike ndërkombëtare, sigurimin e dëshmisë së ShA përmes videolinkut”.

59. Lidhur me refuzimin e gjykatave për dëgjimin e dëshmitarëve Zeqirja Qazimi dhe Sha, parashtruesi i kërkesës shton: *“Derisa në një rën anë Gjykata Themelore e ngarkon dhe e dënon z. Fatos RIZVANOLLI për veprime me relevancë inkriminuese, të cilat pranohen në tërësi si të tilla edhe nga Gjykata e Apelit, në anën tjetër, në mënyrë plotësisht arbitrare, ia ndalon z. Fatos RIZVANOLLI thirrjen e dëshmitarëve, të cilët mund të zbardhin faktet për të cilat z. Fatos RIZVANOLLI është dënuar”*.
60. Për të mbështetur pretendimin për të drejtën për dëgjim të dëshmitarëve ZQ dhe Sha, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit nr. KI78/12, ku, mes tjerash, Gjykata kishte përcaktuar: *“Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se personat që pretendojnë shkeljen e nenit 6.3.d të KEDNJ-së duhet të dëshmojnë që jo vetëm se ata nuk ishin të lejuar për të thirrur një dëshmitar të caktuar, por edhe se dëgjimi i dëshmitarit ishte absolutisht i nevojshëm në mënyrë që të konstatohej e vërteta dhe se dështimi për të dëgjuar dëshmitarin cenoi të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurës si tërësi”*.
61. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës përfundon: *“Në rastin konkret, të z. Fatos RIZVANOLLI, plotësohen të gjitha kushtet e lartpërmendura, të diktuar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, pasi atij iu pamundësua dëgjimi i dëshmitarëve ZQ dhe Sha, dëgjimi i të cilëve ishte absolutisht i nevojshëm për vërtetimin e fakteve të përfshira në dispozitivin e aktakuzës, për të cilat më pas ai u shpall fajtor dhe u dënua me 7 vjet burgim, çka rezultoi me kufizimin e të drejtës së mbrojtjes dhe ndikoi në ndershmërinë e procedurës penale si tërësi, të zhvilluar kundër tij”*.
62. Me qëllim të mbështetjes së pretendimit për shkelje të parimit të kontradiktoritetit, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit nr. KI78/12 nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe disa rasteve nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, *Al Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar, Tarau kundër Rumanisë, Graviano kundër Italisë, etj.*

Pretendimi për përdorim të provave të siguruara në mënyrë të kundërligjshme

63. Për sa i përket përdorimit të provave të siguruara në mënyrë të kundërligjshme, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Mbrojtja e Apelit ka ngatërruar provën e kundërshtuar nga Mbrojtja, duke vlerësuar dhe trajtuar gabimisht pranueshmërinë e provës së kërkuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 4.11.2016, me Prot. Nr. 3002, të lëshuar nga Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve më 23.11.2016 [...] Mbrojtja ka kërkuar përjashtimin e Konfirmimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve Prot. Nr. 1159, të datës 27.05.2016 dhe jo përjashtimin e Konfirmimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve, Prot. Nr. 3002, të datës 23.11.2016”*.

64. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson: “Gjykata e Apelit, ose nuk e ka kuptuar mirë se për cilën provë kërkohej përjashtimi, pavarësisht faktit se ajo ishte detajuar shumë saktë, ose ka dashur që me çdo kusht ta refuzojë këtë pretendim të Mbrojtjes, kinse duke e ngatërruar me një provë tjetër, të siguruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht dallimit të datave, respektivisht 27.05.2016 dhe 23.11.2016”.
65. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se provat e lartpërmendura janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor: “Është provë e papranueshme sepse është marrë PAS PERFUNDIMIT TË AFATIT LIGJOR TË LEJUAR PER PERFUNDIMIN E HETIMEVE (neni 159 i KPP -Hetimi ka filluar me 10.04.2014 dhe ligjërisht ky afat ka përfunduar me ngritje e Aktakuzës, përkatësisht jo më vonë se 10.04.2016) dhe PA asnjë Urdhër apo Aktvendim nga ana e Kryetarit të Trupit Gjyqësor mbi marrjen e provave të reja (neni 288 i KPP)”.
66. Në mbështetje të pretendimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dy tabela me qëllim të pasqyrimin të dallimit midis dy provave.
67. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: “Në ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës themelore, mbrojtja kishte parashtruar se Raporti Njoftues-Analizimi i ekzaminimit të pajisjeve elektronike, me Nr. Ref. 06/1-03/385-2016, i datës 14.07.2016, i renditur nën numrin rendor 2, ishte provë papranueshme, pasi nuk përmbushte kërkesat nga neni 138 KPP dhe neni 147 KPP”. Parashtruesi i kërkesës theksoi se kundërshtimi ndaj provës në fjalë mbështetej në (i) mungesën e autorizimit të organit që kishte kryer ekspertizën; (ii) mungesën e kërkesave substanciale nga nenet 138 dhe 147 të KPP-së.
68. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës shton: “Në vështrim të Raportit Njoftues - Analizimi i ekzaminimit të pajisjeve elektronike me Nr. Ref. 06/1-03/385-2016, të datës 14.07.2016, rezulton se ekspertimi NUK ËSHTË KRYER nga Agjencioni për Forenzikë i Kosovës, si organ i autorizuar nga Prokuroria Speciale për kryerjen e ekspertimit, por nga Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit, organ ky që hyn në organigramën e një tjetër institucioni shtetëror, pra Policisë së Kosovës dhe që NUK ËSHTË AUTORIZUAR asnjëherë nga Prokuroria për kryerjen e ekspertimit të pajisjeve të gjetura në NTSH "Tosi" dhe "AutoMarket”.
69. Parashtruesi i kërkesës thekson: “Agjencioni i Kosovës për Forenzikë dhe Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit, që operon pranë Policisë së Kosovës, JANË DY ORGANE TË NDRYSHME, me përgjegjësi të ndryshme dhe të ndara [...] Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit pranë Policisë së Kosovës NUK KA PASUR ASNJË AUTORIZIM për kryerjen e ekspertizës së pajisjeve elektronike”.
70. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit në mënyrë kontradiktore ka konstatuar se të dy organet: Agjencioni i Kosovës për Forenzikë dhe Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit i Policisë së Kosovës, kanë qenë të autorizuar nga Prokurori.

71. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se prova e kundërshtuar “ka mungesë substanciale të të dhënave të obligueshme, të parashikuara nga nenet 138 dhe 147 të KPP-së”. Parashtruesi i kërkesës vë në vëmendje të Gjykatës se neni 138.3 i KPP-së përcakton: “raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë nen nuk është i pranueshëm”.
72. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ekspertiza e kundërshtuar ka mungesa substanciale të të dhënave të obligueshme, të parashikuara nga nenet 138 dhe 147 të KPP-së, ku, mes tjerash, mungojnë: (i) të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin (neni 138, par. 1, nënpar. 1.1 KPP); (ii) pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale (neni 138 par. 1, nën-par. 1.2 KPP); (iii) përvojën dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime (neni 138, par. 1, nën-par. 1.3 KPP); (iv) përshkrimin e ekspertizës (neni 138, par. 1, nën-par. 1.5 KPP); (v) shpjegimin se praktikatat analitike janë kryesisht të pranuar në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore ose teknike (neni 138, par. 1, nënpar. 1.6 KPP), etj.
73. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës shton: “Për mendimin tonë, Gjykata e Apelit nuk e ka lexuar fare përmbajtjen e dokumentit të kundërshtuar, sepse është absurde dhe aspak e logjikshme që, nëse në njërin anë, në përmbajtjen e Ekspertizës së kundërshtuar nga Mbrojtja, të mungojnë të gjitha të dhënat e mësipërme, në anën tjetër, në mënyrë paqenë dhe kontradiktore, të dhënat substanciale që mungojnë, të konsiderohen si të pranishme dhe të mirëfillta nga Gjykata e Apelit”.

Pretendimi për deklaratën e dëshmitarit IB

74. Për sa i përket deklaratës së dëshmitarit IB, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Në ankesën e ushtruar kundër aktgjyqimit të gjykatës themelore, mbrojtja e z. Fatos RIZVANOLLI kishte parashtruar se Deklarata e IB, e dhënë në Polici me datë 23.05.2015, e renditur nën numrin rendor 12, ishte provë e papranueshme, për shkak se deklarata është dhënë në cilësinë e personit të dyshuar dhe se, në zbatim të nenit 123.5 të KPP, deklaratat e të pandehurit mund të përdoren si provë VETËM kundër tij, por jo edhe kundër pandehurve të tjerë”.
75. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës vë në pah arsyetimin e Gjykatës së Apelit lidhur me dëshminë e IB: “qëndron fakti se gjykata e ka refuzuar propozimin e Prokurorit që të lexohet deklarata e IB e dhënë në Polici me 23.07.2015 dhe përkundër këtij fakti gjykata e mbështet aktgjykimin në këtë deklaratë, por nga kjo nuk mund të theksohet se Aktgjykimi mbështetet në provë të papranueshme, **ngase kjo deklaratë as që është administruar**, kurse mbështetja e Aktgjyqimit në këtë deklaratë nuk e bën aktgjykimin e paqëndrueshëm juridikisht kur kihet parasysh fakti se kjo deklaratë nuk është e vetmja provë vendimtare me të cilën mbështetet Aktgjykimi, respektivisht e vemja provë,

ngase konkludimi i Gjykatës përkitazi me fajësinë e të akuzuarit mbështetet në një mori provash”.

76. Për sa i përket arsyetimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës pohon: “Ky vlerësim i Gjykatës se Apelit, i cili mbështetet në tërësi edhe nga Gjykata Supreme, është i gabuar, i kundërligjshëm, ndaj edhe rrjedhimisht arbitrar, sepse Mbrojtja e z. Fatos RIZVANOLLI nuk ka parashtruar asnjëherë se Aktgjykimin e bën të paqëndrueshëm juridikisht thjesht prania fizike në shkresat e lëndës e deklaratës së Ilir Berishës, dhënë në Polici me 23.07.2015, por e bën të tillë PËRDORIMI dhe TË BAZUARIT e Aktgjykimit mbi këtë deklaratë, e cila ishte refuzuar dhe nuk ishte administruar asnjëherë si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër z. Fatos RIZVANOLLI [...] Meqenëse Deklarata e IB, dhënë në Polici me datë 23.07.2015, NUK ËSHTË PROCEDUAR ASNJËHERË SI PROVË GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR, atëherë e njëjta as nuk duhet të ishte përdorur në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [...] një shkelje e tillë substanciale e Gjykatës Themelore, në kundërshtim me obligimin procedural nga nenet 257.3 dhe 361.1 të KPP, nuk duhej të ishte toleruar aspak as nga Gjykata e Apelit dhe as nga Gjykata Supreme, e aq më tepër nuk duhej të ishte kamufluar dhe legjitimuar, ashtu siç arbitrarisht dhe kundërligjshëm kanë vepruar gjykatat në fjalë [...] nga përmbajtja e shkresave të lëndës, rezulton se E VETMJA PROVË, me të cilën vërtetohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili pranohet në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, është pikërisht dhe ekskluzivisht Deklarata e IB, dhënë në Polici me datë 23.07.2015, të cilin Gjykata Themelore vendosi që mos ta administronte si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër z. Fatos RIZVANOLLI”.

Pretendimi për shkelje të të drejtës së privatësisë

77. Për sa i përket shkeljes së të drejtës së privatësisë, parashtruesi i kërkesës pretendon: “Në rastin konkret të z. Fatos RIZVANOLLI, Mbrojtja e tij, në tërësinë e procedurës penale të zhvilluar kundër të njëjtit, vazhdimisht ka kundërshtuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Urdhërave të mëposhtme, duke kërkuar veçimin e tyre nga shkresat e lëndës: (i) Urdhëresa për Fotografimin e fshehtë ose Vëzhgimin me Video në vendet private e datës 10.04.2014; (ii) Urdhëresa për Fotografimin e fshehtë ose Vëzhgimin me Video në vendet private dhe Monitorimin e fshehtë të bisedave në vendet private e datës 10.04.2014; (iii) Urdhëresa për Regjistrimin e thirrjeve telefonike e datës 10.04.2014; Urdhëresa për zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të datës 10.04.2014; (iv) Urdhri për masa të fshehta, Përgjim të komunikimeve, Lexim i mesazheve SMS dhe Regjistrim i thirrjeve telefonike i datës 08.05.2015; (v) Urdhëresa për nxjerrjen e regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe SMS të shkruara e datës 13.05.2014; (vi) Urdhri për masa të fshehta, Përgjim të komunikimeve, Lexim i mesazheve SMS dhe Regjistrim i thirrjeve telefonike i datës 22.12.2014”.
78. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës shton: “Të tilla prova janë kundërshtuar për shkak të kundër kushtetutshmërisë së tyre, për shkak se Gjykata ka dështuar që të zbatojë DETYRIMIN PROCEDURAL NGA NENI 88 KPP, sepse NUK KA

SHPJEGUAR ARSYET SI dhe PSE informacioni i siguruar përmes masës hetimore të fshehtë, ka gjasa që të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe PËRSE hetimi nuk mund të kryhej nëpërmjet mjeteve të tjera hetimore me pak invazive [...] Përfaqësuesi i autorizuar i z. Fatos RIZV ANOLLI me respekt parashtron se kundërligjshmëria e Urdhëresave për autorizimin dhe zbatimin e masave të fshehta të betimit dhe vëzhgimit, kanë rezultuar në shkeljen e të drejtës për privatësi, nga neni 36.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe inter alia neni 8 i KEDNJ, për shkak të dështimit të gjykatave për të arsyetuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave në fjalë [...] në të gjitha urdhëresat e lartpërmendura mungon arsyetimi se si dhe pse informacioni i siguruar përmes masës së fshehtë ka gjasa që të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe se përse hetimi nuk do të mund të zhvillohej nëpërmjet masave tjera më pak invazive”.

79. Parashtruesi i kërkesës pohon se gjykatat kanë shkelur nenin 36.3 të Kushtetutës dhe 8 të KEDNJ-së për shkak të mos respektimit të dispozitave ligjore të nenit 88 të KPP-së dhe nenit 4 të Ligjit për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike Nr. 05/L-030.
80. Për të mbështetur pretendimin e tij se urdhëresat e lartpërmendura nuk janë të arsyetuara, parashtruesi i kërkesës ka cituar të gjitha urdhëresat. Për shembull, Urdhëresa për nxjerrjen e regjistrit të thirrjeve telefonike dhe SMS të shkruara të 13.05.2014, urdhëron: *“Gjyqtari i procedurës paraprake, pasi vlerësoi bazueshmërinë e kësaj kërkesë, konstatoi se informacioni i siguruar përmes kësaj mase ka gjasa të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi që të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët”.*
81. Për të mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 36.3 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, *Dragojević kundër Kroacisë, Bašić kundër Kroacisë dhe Roman Zakharov kundër Ruisë.*

Pretendimi për shkelje të të drejtës për mos dënim pa ligj

82. Për sa i përket të drejtës për mos dënim pa ligj i garantuar me nenin 33.1 të Kushtetutës dhe 7 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon: “Përshkrimi i rrethanave dhe i fakteve vendimtare në pikat I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili pranohet në tërësi edhe nga gjykatat e rregullta, NUK PËRPUTHET ME ASNJË ELEMENT KONSTITUTIV të veprës penale Rekrutimi për terrorizëm, nga neni 139 i KPK [...] Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, si dhe në tërësinë e arsyetimit të tij, i cili aprovohet nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, rezulton se Gjykata Themelore ka dështuar që të tregojë se KUJT, KUR, SI dhe PËR ÇFARË, z. Fatos RIZVANOLLI i ka bërë thirrje”.
83. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës shton: “Cilësimi juridik i veprës si Rekrutim për Terrorizëm në bashkëkryerje, nga neni 139 lidhur me nenin 31 të KP, është juridikisht i paqëndrueshëm, i paqartë dhe arbitrar për shkak se, edhe pse veprimet e z. Fatos RIZVANOLLI, në tërësinë e dispozitivit dhe të arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili mbështetet në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, cilësohen të jenë kryer në bashkëkryerje me ZQ dhe IB, në Aktgjykimin e formës së prerë me të cilin këta dy persona janë dënuar (pra ZQ dhe IB), NUK PËRMENDET aspak emri i z. Fatos RIZVANOLLI dhe as nuk rezulton që të jenë administruar prova në të cilat të përmendej emri i z. Fatos RIZVANOLLI.”
84. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, mes tjerash, nuk kanë arsytuar: (i) se përse në kohën e marrjes me qira të automjeteve personat Sh.A., S.H., L.M., Z.Q., I.B. dhe I.B., janë konsideruar pjesëtarë të organizatave terroriste ISIS dhe Al Nusra; (ii) rrethanat konkrete se si ka qenë në dijeni për aktivitetin e tyre terrorist dhe çfarë lidhje kishin automjetet e shfrytëzuara me qira në këto aktivitete terroriste; dhe, (iii) vetëdijen dhe dashjen direkt të parashtruesit të kërkesës për t’iu ndihmuar pjesëtarëve të organizatave terroriste ISIS dhe Al Nusra (kusht i domosdoshëm për fajësinë dhe element subjektiv thelbësor i veprës penale).
85. Parashtruesi i kërkesës përfundon: “Dështimet e mësipërme të gjykatave të rregullta kanë rezultuar në shkeljen e nenit 6 të KPK, si dhe të parimit Nullum Crimen Sine Lege dhe Nulla Poena Sine Lege, sepse në veprimet e z. Fatos RIZVANOLLI, të përfshira në dispozitivin e Aktgjykimit fajësues, nuk formësohet asnjë element i veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor dhe është dënuar”.
86. Për të mbështetur pretendimet e tij, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Engel dhe të tjerët kundër Holandës, Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës, Del Rio Prada kundër Spanjës, etj.

Dispozitat relevante ligjore

KODI I PROCEDURES PENALE Nr. 04/L-123

Neni 88

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:
 - 1.1. ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe
 - 1.2. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.
2. Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare po ashtu mund të urdhërohet kundër personave, përpos të dyshuarit, kur kushti në nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:
 - 2.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit; ose
 - 2.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.
3. Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:
 - 3.1. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë veprë penale nga neni 90 i këtij Kodi;
 - 3.2. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.
4. Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur kushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.1. i këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:

4.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose

4.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik.

Neni 123

Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë

[...]

5. Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.

Neni 138

Raporti i ekspertit

1. Raporti i ekspertit përmban:

1.1. të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;

1.2. pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;

1.3. përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;

1.4. përshkrimi i provave që janë analizuar;

1.5. përshkrimi i ekspertizës, përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.

1.6. shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuar në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe

1.7. përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet në paragrafin 2. të këtij neni, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

2. Eksperti nuk shpreh ne raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

3. Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë nen nuk është i pranueshëm.

4. Raporti i ekspertit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

5. Raporti i ekspertit i zbulohet të pandehurit apo mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit jo më pak se pesë (5) ditë para fillimit të seancës për deklarata në procedurë paraprake nga eksperti, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi që prokurori i shtetit të ketë pranuar raportin e ekspertit.

Neni 147 **Analiza kompjuterike**

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Për pajisjet kompjuterike, pajisjet elektronike të ruajtjes apo pajisje të ngjashme që janë marrë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet një urdhri të gjykatës ose me pëlqim, prokurori i shtetit mund të autorizojë zyrtarin e policisë apo ekspertin për të shqyrtuar, analizuar dhe kërkuar për informata ose të dhëna që gjenden brenda pajisjeve kompjuterike, pajisjeve elektronike për ruajtje ose pajisjeve të ngjashëm.
3. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër duhet të ketë arsimim, trajnim ose përvojë në analizat dhe kërkimin kompjuterik.
4. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër nxjerrë raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi, që do të përfshijë të dhënat e mëposhtme:
 - 4.1. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan pajisjet kompjuterike, pajisjet për ruajtjen e të dhënave, ose dosjet e veçanta kompjuterike të ekzaminuara, përfshirë edhe ndonjë emër identifikimi, numra ose etiketa të provave.
 - 4.2. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan se ku dhe si janë marrë nga policia pajisjet kompjuterike, pajisjet për ruajtje të dhënave ose dosjet e veçanta kompjuterike.
 - 4.3. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan radhën e mbikëqyrjes së pajisjeve kompjuterike, pajisjeve për ruajtjen e të dhënave ose dosjeve të veçanta kompjuterike.
 - 4.4. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan informacionin specifik faktik për të cilin ka qenë i autorizuar për të kërkuar në pajisje kompjuterike, pajisje për ruajtje të të dhënave ose dosje të veçanta kompjuterike.
 - 4.5. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan hapat e ndërmarrë në përputhje me praktikat më aktuale në fushën e forenzikës kompjuterike për të realizuar kërkimin në mënyrë të saktë dhe të besueshme, përfshirë por pa u kufizuar në hapat e ndërmarrë për të mbrojtur kundër humbjes së dosjeve, deshifrimit të dosjeve, rikthimit të dosjeve të fshira apo marrjen e të dhënave nga dosjet kompjuterike ose emailat.
 - 4.6. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan rezultatet e kërkimit dhe i bashkëngjet kopjen elektronike të dosjeve kompjuterike që janë të rëndësishme për kërkimet.

KAPITULLI XVI **PROVAT**

Neni 257 **Rregullat e përgjithshme për prova**

1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit të shtetit dhe policisë.
2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.
3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.
4. Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndaloheq që:
 - 4.1. liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;
 - 4.2. i pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;
 - 4.3. të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe
 - 4.4. të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.
5. Ndalesa nga paragrafi 4. i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje.
6. Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 4. të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 04/L-082

Neni 139 Rekrutimi për terrorizëm

Kushdo që i bën thirrje personit tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, të marrë pjesë në aktivitetet e grupit terrorist apo të sigurojë fonde ose burime materiale, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 31 Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

LIGJI PËR PËRGJIMIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE Nr. 05/L -030

Neni 4 Parimet themelore me rastin e përgjimit

1. Parimet themelore dhe udhëheqëse me rastin e përgjimit në përputhje me këtë ligj janë:

1.1. respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, përfshirë dhe ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmes praktikës së saj gjyqësore;

1.2. ndalimi i përgjimit pa një vendim përkatës gjyqësor. Përgjim i ligjshëm konsiderohet vetëm ai për të cilin është lëshuar urdhër i ligjshëm nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin.

2. Me rastin e marrjes së vendimit për përgjim, gjykata kompetente bartë detyrimin për t'u kujdesur për:

2.1. esencën e të drejtave dhe lirive të personave për të cilët është bërë kërkesë përgjimi;

2.2. rëndësinë, nevojën e përgjimit, dhe proporcionalitetin;

2.3. natyrën, mjetet dhe vëllimin e përgjimit;

2.4. raportin në mes të qëllimit që synohet të arrihet dhe mundësisë së realizimit të këtij qëllimi me metoda tjera hetuese; dhe

2.5. sekretin dhe objektivitetin gjatë kryerjes së përgjimit.

3. Me rastin e vendosjes për një kërkesë përgjimi dhe përpara se të autorizohet përgjimi si masë hetuese ose e mbledhjes së informacionit, gjykata kompetente duhet të sigurohet që janë shtjerrë të gjitha masat tjera të hetimit ose të mbledhjes së informacionit.

4. Bazuar në Kushtetutën e Kosovës ku liria e shprehjes dhe e mediave garantohet dhe është standard i të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike, gjykata kompetente është e obliguar të mbrojë të drejtat e gazetarëve për ruajtjen e burimeve të informacionit dhe për mos zbulimin e burimit të mbrojtur të informatës të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë dhe Kodin Penal të Kosovës gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si pjesë e lirisë së shprehjes dhe informimit të publikut përcjellë me garancionet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe praktikën e gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi mbrojtjen e burimeve të gazetarëve.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

87. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
88. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

89. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

90. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1)Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

91. Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, për të gjitha pretendimet kryesore (përveç për pretendimin për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit), në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e parashikuar në nenin 49 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës, poashtu, saktësisht i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë cenuar dhe aktet e autoriteteve publike që i konteston, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit.
92. Gjkata sjellë në vëmendje pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e gjykatave të rregullta i kanë shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet kushtetuese në vijim: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33.1 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 7 (Nuk ka dënim pa ligj), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së.
93. Gjkata do i adresojë veç e veç secilin nga këto pretendime, që kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e privatësisë dhe parimin e mosdënimit pa ligj.
94. Gjkata, në vijim, do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi, me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e privatësisë dhe parimin e mosdënimit pa ligj duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjkata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Pretendimet për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

95. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta në rastin e tij kanë shkelur disa komponenta të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm: (i) parimin e paanshmërisë së gjykatës; (ii) të drejtën për dëgjimin e dëshmitarëve dhe parimin e barazisë së armëve; (iii) ndalimi i përdorimit të provave të siguruara në mënyrë të kundërligjshme; dhe, (iv) të drejtën për një vendim të arsyetuar.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të të drejtës për gjykatë të paanshme

96. Gjkata sjellë në vëmendje pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjkata e Apelit (Aktvendim PN. Nr. 609/16, 25 gusht 2016) ka shkelur parimin e paanshmërisë, duke qenë se kryetarja e kolegjit, gjyqtarja H.H., si dhe gjyqtari referues D.M., kishin marrë pjesë paraprakisht në të njëjtën procedurë penale, me

rastin e konfirmimit të Aktakuzës kundër parashtruesit të kërkesës, në po të njëjtat cilësi.

97. Gjykata vëren se pretendimi për paanshmërinë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese.
98. Gjykata thekson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë një pretendim apo një çështje që nuk është ngritur dhe vlerësuar paraprakisht nga gjykatat e rregullta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI89/15, *Parashtrues Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35).
99. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutes apo të korrigjohen shkeljet e tilla pasi ato të kenë ndodhur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë mundësitë në procedurat pranë gjykatave të rregullta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI24/16, *Parashtrues Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
100. Rrjedhimisht, ky pretendim shpallet i papranueshëm për shkak të mosshterimit në substancë të mjetit juridik në procedurë në Gjykatën Supreme.

Pretendimi për refuzim të dëgjimit të dëshmitarëve ZQ dhe ShA

Parime të përgjithshme nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

101. Kriteri për të pasur arsye të mirë për mos praninë e dëshmitarit është çështje paraprake që duhet shqyrtuar para se të jepet ndonjë vlerësim nëse dëshmia ka qenë “e vetme” apo “vendimtare”. Kurdo që dëshmitarët nuk janë të pranishëm në gjykim, ekziston obligimi për të hetuar nëse mungesa e tyre është justifikuar (*Al Khawaja dhe Taheri kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [DHM], paragrafi 120).
102. Në këtë kontekst edhe pse funksioni i GJEDNJ-së nuk është shprehja e mendimit për rëndësinë e dëshmive të nxjerra, dështimi për të justifikuar mos marrjen në pyetje ose mos thirrjen e dëshmitarit mund të përbëjë kufizim të të drejtave të mbrojtjes që është i papajtueshëm me garancitë e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm (*Bocos Cuesta kundër Holandës*, paragrafi 72).
103. Neni 6. par. 1. dhe 3 (d) i KEDNJ-së, parashikojnë se gjykatat duhet të ndërmarrin hapa pozitiv për t'ia mundësuar të akuzuarit që të pyesë ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës (*Trofimov kundër Rusisë*, paragrafi 33 dhe *Cafagna kundër Italisë*, paragrafi 42).

104. Në rast të pamundësisë për t'i pyetur dëshmitarët për shkak të mungesës, gjykatat duhet të përpiqen arsyeshëm për të siguruar praninë e tyre (*Karpenkov kundër Rusisë*, paragrafi 62; *Damir Sibgatullin kundër Rusisë*, paragrafi 51; *Pello kundër Estonia*, paragrafi 35; *Bonev kundër Bullgarisë*, paragrafi 43; *Tseber kundër Republikës Çeke*, paragrafi 48; *Lučić kundër Kroacisë*, paragrafët 79-80). Nuk i takon Gjykatës për të përpiluar një listë specifike masash që gjykatat e rregullta duhet t'i ndërmarrin për t'i bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për sigurimin e pranisë së dëshmitarit për të cilin ato në fund kanë vlerësuar se është i paarritshëm. Megjithatë, është e qartë se ato është dashur ta kenë kërkuar në mënyrë aktive dëshmitarin me ndihmën e autoriteteve publike përfshirë dhe policinë dhe është dashur, si rregull, që të mbështeten në ndihmën ligjore ndërkombëtare në rastet ku dëshmitari jeton jashtë vendit dhe ku mekanizmat e tillë janë në dispozicion. Veç kësaj, nevoja për përpjekje të arsyeshme nga gjykatat për të siguruar praninë e dëshmitarit në gjykim flet për shqyrtim të kujdesshëm nga gjykatat e rregullta për arsyet e dhëna për pamundësinë e dëshmitarit që të jetë i pranishëm në gjykim, duke pasur parasysh situatën specifike të secilit dëshmitar (*Schatschaschwili kundër Gjermanisë* [DHM], paragrafët 121-122).
105. Nga këndvështrimi i gjykatës së faktit duhet të ekzistojnë arsye të mira për mungesë të dëshmitarit, çka do të thotë, se gjykata duhet të ketë bazë të mirë faktike dhe ligjore për mos sigurimin e pranisë së dëshmitarit në gjykim. Nëse ka pasur arsye të mirë për mos praninë e dëshmitarit në atë kuptim, atëherë, ka pasur arsye të mirë, apo justifikim, për gjykatën e faktit për t'i pranuar deklaratat të pa sfiduara të dëshmitarit të munguar si dëshmi (*Schatschaschwili kundër Gjermanisë* [DHM], paragrafi 119).
106. Ka një mori arsyes pse një dëshmitar mund të mos jetë i pranishëm në gjykim, siç është mungesa për shkak të vdekjes ose frikës (*Mika kundër Suedisë* (aktvendim), paragrafi 37; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, §52; *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], paragrafët 120-125), mungesa për shkaqe shëndetësore (*Bobes kundër Rumanisë*, paragrafët 39-40; *Vronchenko kundër Estonisë*, paragrafi 58), apo kur dëshmitari është i paarritshëm (*Schatschaschwili kundër Gjermanisë* [DHM], paragrafët 139-140; *Lučić kundër Kroacisë*, paragrafi 80), përfshirë paraburgimin e tij jashtë vendit (*Štefančič kundër Sllovenisë*, § 39).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme ndaj rrethanave të rastit konkret

107. Gjykata sjellë në vëmendje pretendimin e parashtruesit të kërkesës për refuzimin e dëgjimit në cilësi të dëshmitarit ZQ: “*se refuzimi i gjykatës themelore për ta dëgjuar dëshmitarin ZQ është i kundërligjshëm sepse emri i dëshmitarit në fjalë është përmendur në aktakuzë si person me të cilin parashtruesi i kërkesës ka “bashkëpunuar në kryerjen e veprave penale”. Emri i dëshmitarit ZQ është i pranishëm edhe në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës themelore, i cili pranohet në tërësi edhe nga gjykata e apelit”.*

108. Gjykata po ashtu sjellë në vëmendje pretendimin e parashtruesit të kërkesës për refuzimin e dëgjimit në cilësi të dëshmitarit ShA: *“Në po të njëjtën mënyrë, edhe pse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës themelore, i cili pranohet në tërësi edhe nga gjykata e apelit, z. FATOS RIZVANOLLI ngarkohet me veprim inkriminues të vënies në dispozicion, më datë 17.10.2011, të automjetit tip “Toyota” me targa 01-877-CF në favor të personit ShA, gjykata themelore e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për ta thirrur z. ShA në cilësinë e dëshmitarit me arsyetimin se “prania e tij në gjykatë dhe sigurimi i tij që të dëshmojë dejtpërdrejtë në Gjykatë, është shumë i vështirësuar dhe i pamundur [...] Gjykata Themelore edhe pse dinte vendndodhjen e ShA, për shkak se posedonte një Raport Ekstradimi të tij në Maqedoni, nuk bëri as edhe një përpjekje të vetme për tu vënë në kontakt me autoritetet maqedonase dhe për të siguruar dëshminë e tij përmes videolinkut, në kundërshtim të plotë me garancitë procedurale të nenit 6 (3) të KEDNJ”.*
109. Për sa i përket refuzimit për dëgjim në cilësi të dëshmitarëve ZQ dhe ShA, Gjykata vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës së Apelit: *“Po ashtu është evidente se përkundër faktit se gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtjes që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit ZQ e ShA ajo nuk ka dhënë arsye në aktgjykim në këtë drejtim, mirëpo, nga procesverbali shqyrtimit gjyqësor rezulton se me rastin e refuzimit të këtij propozimi gjykata ka dhënë arsye, të cilat arsye si të drejta i aprovon edhe kjo Gjykate dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë vlerësime në këtë drejtim”* (shih rreshti 23, faqe 6 i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 100/2017, i 23 majit 2017).
110. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në Procesverbal të Vazhdimit të Shqyrtimit Gjyqësor PKR.65/16 të 4 nëntorit 2016, rezulton se mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës kishte kërkuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen personat ZQ, BK dhe BR kurse Prokurori i Shtetit kishte deklaruar se e kundërshton propozimin e mbrojtjes sepse personat e propozuar që të dëgjohen si dëshmitar, kanë interes të drejtpërdrejtë ta ndihmojnë parashtruesin e kërkesës dhe se njëanshmeria e tyre argumentohet nga statusi i tyre në procedura të ndryshme penale, disa të dyshuar e të akuzuar dhe për vepra të ndryshme të terrorizmit. Trupi gjykues, pas një konsultimi të shkurtër, vendosi që, mes tjerash, të aprovohen propozimet e mbrojtjesit të parashtruesit të kërkesës që të dëgjohen në cilësi të dëshmitarit BK dhe BR. Trupi gjykues refuzoi dëgjimin e ZQ me arsyetimin: *“Ndërkaq refuzohet propozimi që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet ZQ me që prania dhe dëgjimi i tij si dëshmitar nuk do të jetë objekt i çështjes penale dhe se pretendimet e aktakuzës në këtë çështje nuk kanë ndonjë lidhje ose relevancë me veprimet e të akuzuarit”.*
111. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me pretendimin për dëgjim në cilësi të dëshmitarëve të personave ZQ dhe ShA nuk rezultojnë të jenë të njollosura nga arbitrariteti apo jo proporcionale sepse Gjykata Themelore ka gjetur “balancën e drejtë” duke pranuar dëgjimin e personave BK dhe BR të propozuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, në njërën anë, kurse ka refuzuar dëgjimin e personave ZQ dhe ShA, në anën tjetër. Gjykata po ashtu konsideron se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë mundur që ta shtjellojnë më tepër çështjen e dëgjimit të dëshmitarëve-por kjo në vetvete-nuk e

bën procesin kundërkushtetues sepse, nga dokumentet në dispozicion, rezulton se parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje në substancë ndaj pretendimit të tij për shkelje të nenit 31.4 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. par. 3 (d) të KEDNJ-së.

112. Si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave të rregullta që të vlerësojnë dëshmitë si dhe rëndësinë e dëshmive që parashtruesi i kërkesës kërkon t'i nxjerrë. Neni 31.4 i Kushtetutës dhe neni 6. par. 3 (d) i KEDNJ-së ua lë gjykatave të rregullta, sërish si rregull i përgjithshëm, vlerësimin nëse është e nevojshme të thirren dëshmitarët. Këto nene nuk kërkojnë praninë dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në interes të të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës); qëllimi thelbësor i tyre është barazia e plotë a armëve në procesin penal (shih rastet e GJEDNJ-së, *Perna kundër Italisë*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 29; *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafi 139; *Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57). Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk i akordojnë të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) të drejtën e pakufizuar të pranisë së dëshmitarëve në gjykatë. Zakonisht u takon gjykatave të rregullta që të vendosin nëse është e nevojshme apo e këshillueshme marrja në pyetje e dëshmitarit (shih rastet e GJEDNJ-së, *S.N. kundër Suedisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2002, paragrafi 44; *Accardi dhe të tjerët kundër Italisë*, Vendim për pranueshmëri i 20 janarit 2005).
113. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.

Pretendimi për dëshminë e dëshmitarit IB

114. Gjykata vë në pah arsyetimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me deklaratën e dëshmitarit IB: “[...] Së, katërti, qëndron fakti se gjykata e ka refuzuar propozimin e Prokurorit që të lexohet deklarata e IB e dhënë në polici me 23.05.2015 dhe përkundër këtij fakti i gjykata e mbështet aktgjykimin në këtë deklaratë, por nga kjo nuk mund të theksohet se aktgjykimi mbështetet në provë e papranueshme, ngase kjo deklaratë as që është administruar, kurse mbështetja e aktgjykimit në këtë deklaratë nuk e bën aktgjykimin juridikisht të paqëndrueshëm kur kihet parasysh fakti se kjo deklaratë nuk është e vetmja provë vendimtare në të cilën mbështet aktgjykimi, respektivisht e vetmja provë, ngase konkludimi i gjykatës përkritazi me fajësinë e të akuzuarit mbështetet në një mori provash” (shih Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 100/2017, i 23 majit 2017).
115. Gjykata po ashtu vë në pah arsyetimin e Gjykatës Supreme në lidhje me deklaratën e dëshmitarit IB: “Një prej pretendimeve në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ishte se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e vet e ka bazuar edhe në deklaratën e IB të dhënë jo vetëm në shqyrtimin gjyqësor por në polici, edhe pse në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.11.2016. e njëjta është shpallur provë e papranueshme. Duke e vlerësuar këtë pretendim, Gjykata Supreme konstatojë se në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.11.2016. deklarata e dëshmitarit IB nuk është shpallur provë e papranueshme por është refuzuar propozimi i prokurorit që të lexohet. Më konkretisht, në faqen

11 të këtij procesverbali, është konstatuar se "refuzohet propozimi që të lexohet dhe si provë të përdoret deklarata e të pandehurit IB e dhënë në procedurën paraprake me datën 23.07.2015. duke u bazuar në nenin 123.par.5. dhe duke u ndërlidhur me nenin 263.dhe 261.të KPPK". Për më tepër, i emëruari ka dhënë deklaratë në shqyrtimin gjyqësor dhe ka qenë e drejtë e gjykatës që atë të krahasojë me deklaratën e mëparshme, ndërsa kjo provë nuk ka qenë provë e vetme në cilën gjykata është bazuar me rastin e marrjes së aktgjykimit".

116. Gjykata gjithashtu rithekson pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me deklaratën e dëshmitarit IB: "Ky vlerësim i Gjykatës se Apelit, i cili mbështetet në tërësi edhe nga Gjykata Supreme, është i gabuar, i kundërligjshëm, ndaj edhe rrjedhimisht arbitrar, sepse Mbrojtja e z. Fatos RIZVANOLLI nuk ka parashtruar asnjëherë se Aktgjykimin e bën të paqëndrueshëm juridikisht thjesht prania fizike në shkresat e lëndës e deklaratës së IB, dhënë në Polici me 23.07.2015, por e bën të tillë PËRDORIMI dhe TË BAZUARIT e Aktgjykimit mbi këtë deklaratë, e cila ishte refuzuar dhe nuk ishte administruar asnjëherë si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër z. Fatos RIZVANOLLI [...] Meqenëse Deklarata e IB, dhënë në Polici me datë 23.07.2015, NUK ËSHTË PROCEDUAR ASNJËHERË SI PROVË GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR, atëherë e njëjta as nuk duhet të ishte përdorur në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [...] një shkëlqe e tillë substanciale e Gjykatës Themelore, në kundërshtim me obligimin procedural nga nenet 257.3 dhe 361.1 të KPP, nuk duhej të ishte toleruar aspak as nga Gjykata e Apelit dhe as nga Gjykata Supreme, e aq më tepër nuk duhej të ishte kamufluar dhe legjitimuar, ashtu siç arbitrarisht dhe kundërligjshëm kanë vepruar gjykatat në fjalë [...] nga përmbajtja e shkresave të lëndës, rezulton se E VETMJA PROVË, me të cilën vërtetohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili pranohet në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, është pikërisht dhe ekskluzivisht Deklarata e IB, dhënë në Polici me datë 23.07.2015, të cilin Gjykata Themelore vendosi që mos ta administronte si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër z. Fatos RIZVANOLLI".
117. Sa i përket çështjes së administrimit të provave, Gjykata vëren se Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk përcaktojnë rregulla për pranimin e provave si të tilla (shih rastin *Mantovanelli kundër Francës*, GJEDNJ, ankesë nr. 21497/93, Aktgjykimi i 18 marsit 1997, në paragrafi 34). Pranueshmëria e provave dhe mënyra se si duhet të vlerësohen janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen me të drejtën vendore dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28). E njëjta vlen edhe për vlerën provuese të provave dhe barrën e të provuarit (*Tiemann kundër Francës dhe Gjermanisë* (vend.). Gjithashtu, gjykatat e rregullta duhet të vlerësojnë rëndësinë e provave të propozuara (shih rastin e *Qendra Evropiane 7 S.r.l dhe Di Stefano kundër Italisë* [DHM], kërkesa ne. 38433/09, Aktgjykimi i 7 qershorit 2012, paragrafi 198).
118. Megjithatë, detyra e Gjykatës sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së është të konstatojë nëse procedurat në tërësi janë të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave (shih rastin e *Elsholz kundër Gjermanisë* [DHM], ankesë nr. 25735/94,

Aktgjykimi i 13 korrikut 2000 në paragrafin 66). Prandaj, Gjykata duhet të përcaktojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë ashtu që të garantojnë një gjykim të drejtë (shih rastin e *Blücher kundër Republikës Çeke*, GJEDNJ, ankesë nr. 58580/00, Aktgjykimi i 11 janarit 2005, paragrafi 65).

119. Nga përmbajtja e kërkesës rezulton: (i) se gjykata themelore ka refuzuar propozimin e prokurorit për lexim të deklaratës së dëshmitarit IB; (ii) se gjykata themelore ka konkluduar se deklarata e dëshmitarit IB e dhënë në Polici më 23.07.2015 nuk mund të përdoret si provë bazuar në nenin 123.5 [Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë] të KPP-së lidhur me nenet 261 [Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor] dhe 263 [Mbështetja e pohimit] të KPP-së.
120. Për sa më sipër, administrimi si provë e deklaratës së dëshmitarit IB-në vetveten nuk ka paragjykuar procesin penal në tërësinë e tij çka nuk ka rezultuar me shkelje të garancive procedurale të nenit 31.4 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. par. 1 dhe 3 (d) të KEDNJ-së.
121. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.

Pretendimi për provën nr. 1159 të Agjencisë së Regjistrimit Civil-Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve

122. Parashtruesi i kërkesës pretendon se prova nr. 1159 e Agjencisë së Regjistrimit Civil-Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve është: (i) provë e papranueshme sepse është marrë jashtë afatit ligjor të parashikuar me nenin 159 të KPP-së; dhe se, (ii) Gjykata e Apelit ka ngatërruar provën nr. 1159 me provën nr. 3002, që të dyja të marra nga Agjencia e Regjistrimit Civil-Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve.
123. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës thekson: “*Mbrojtja e Apelit ka ngatërruar provën e kundërshtuar nga Mbrojtja, duke vlerësuar dhe trajtuar gabimisht pranueshmërinë e provës së kërkuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 4.11.2016, me Prot. Nr. 3002, të lëshuar nga Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve më 23.11.2016 [...] Mbrojtja ka kërkuar përjashtimin e Konfirmimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve Prot. Nr. 1159, të datës 27.05.2016 dhe jo përjashtimin e Konfirmimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve, Prot. Nr. 3002, të datës 23.11.2016*” [...] “*Është provë e papranueshme sepse është marrë PAS PERFUNDIMIT TË AFATIT LIGJOR TË LEJUAR PER PERFUNDIMIN E HETIMEVE (neni 159 i KPP -Hetimi ka filluar me 10.04.2014 dhe ligjërisht ky afat ka përfunduar me ngritje e Aktakuzës, përkatësisht jo më vonë se 10.04.2016) dhe PA asnjë Urdhër apo Aktvendim nga ana e Kryetarit të Trupit Gjyqësor mbi marrjen e provave të reja (neni 288 i KPP)*”.
124. Në lidhje me pretendimet e lartpërmendura, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar: “[...] Së, pari qëndron fakti se Konfirmimi i Agjencisë së Regjistrimit Civil,

Drejtorisë për Regjistrim të Automjeteve është prove qe marre pas përfundimit të hetimeve, por nga kjo nuk mund të konkludohet se kjo provë është e papranueshme ashtu siç pa bazë pretendon mbrojtësi ngase kjo provë është marre gjate shqyrtimit gjyqësor. Ngase rezulton nga shkresat e lëndës respektivisht procesverbali i shqyrtimit gjyqësor (datë 4.11.2016) se pas administrimit provave në pyetjen e parashtruar nga gjykata për palët se a kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave Prokurori ka kërkuar që në kontest të provës nr.16 -librat për mbajtjen e evidencës për veturat e dhëna me qira të N.T:SH. "Tosi" dhe N.T.SH "Automarket" t'i dorëzohen gjykatës pesë foldera në origjinal me qëllim të provohet autenciteti dhe origjinaliteti i këtyre dokumenteve respektivisht i pjesëve të cilat i kanë propozuar dhe pjesëve tjera, kurse mbrojtësi ka propozuar që Gjykata të siguroj nga Qendra për Regjistrimin e Automjeteve lista e të gjitha veturave të regjistruara në emër të N.T.SH "Tosi" për periudhën kohore që përmendet në aktakuzë, kurse përkundër faktit se Prokurori e ka kundërshtuar një propozim të tillë me arsyetimin se është e panevojshme për shkakun se informacionet relevante sa i përket akuzës i janë afruar gjykatës. Gjykata respektivisht trupit gjykues me aktvendim e ka aprovuar propozimin e mbrojtësit, për çka konform nenit 66 te KPP i ka bërë kërkesë (7. 11.2016) kësaj Qendre që t' ia dërgoj listën e të gjitha veturave të regjistruara në emër të N.T.SH "Tosi" për periudhën kohore siç ka kërkuar mbrojtësi. Duke pasur parasysh këtë fakt respektivisht faktin se kjo provë është administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor me kërkesën e mbrojtësit për çka gjykata ka marr aktvendim pa bazë pretendohet se ajo është e papranueshme sepse për sigurimin e saj nuk rezulton ndonjë kërkesë e Prokurorisë për pranimin apo refuzimin e saj apo urdhër i kryetarit të trupit gjykues mbi pranimin apo refuzimin e saj. Sipas dispozitës së nenit 288 par. 1 të KPP palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtimin gjyqësor të thirren dëshmitar dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Ndërsa, sipas par.2 gjykata e aprovon kërkesën kur konsideron se është e bazuar respektivisht e drejta e të pandehurit në gjykim mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën, kurse, vetëm në rastet kur ajo e refuzon kërkesën ajo me urdhër e bën një gjë të tillë ngase ky urdhër sipas par. 3 të nenit të lartcekur mund të ankimohet brenda 48 orëve. Në rastin konkret gjykata e ka aprovuar propozimin e mbrojtësit për nxjerrjen e kësaj prove me aktvendim, kurse me kërkesë i është drejtuar organit kompetent dhe vetëm nga fakti se gjykata me kërkesë i është drejtuar organit kompetent nuk mund të konkludohet se ajo është e papranueshme” (shih Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. Nr. 100/2017, i 23 majit 2017, fq.4, rreshti 41).

125. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë administruar provën e kontestuar duke u bazuar në nenin 288 [Kërkesat pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor] dhe nenin 66 [Detyrimet e organeve publike] të KPP-së, çka i detyron organet e tjera kompetente që në procedurë penale t'u japin ndihmën e nevojshme gjykatave, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale ose vendndodhjen e kryerësve.

126. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për interpretim të gabuar të nenit 159 të KPP-së, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore në rastin nr. KI13/16 kishte përcaktuar: *“Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e bazon pretendimin e tij për interpretimin e gabuar të nenit 159 të KPP-së të bërë nga Gjykata Supreme, në lidhje me Prokurorin Special i cili ka ngritur aktakuzën 2 (dy) vjet pas fillimit të hetimeve. Ky argument procedural ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe, për këtë arsye, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, Gjykata nënvizon se “dështimi për mosrespektimin e afatit të parashikuar me ligjin vendor në vetvete nuk bie në kundërshtim me nenin 6, paragrafin 1 të Konventës”* (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI13/16, Parashtrues, *Armend Selimi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2016, paragrafi 37, dhe po ashtu shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rastin *Mitkus kundër Letonisë*, ankesë nr. 7259/03, Aktgjykimi i 2 tetorit 2012, paragrafi 88).
127. Kurse sa i përket pretendimit të parashtruesit për vlerësimin ose përjashtimin e njëjës provë në vend të tjetrës, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç nëse dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mundet vetë të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend se një tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufijve të juridiksionit të saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin KI13/16, cituar më lart, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
128. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.

Pretendimi për ekzaminimin e pajisjeve elektronike

129. Parashtruesi i kërkesës pretendon se pajisjet elektronike janë ekzaminuar nga organi i paautorizuar nga Prokuroria.
130. Për sa më sipër, parashtruesi i kërkesës pohon: *“Në vështrim të Raportit Njoftues -Analizimi i ekzaminimit të pajisjeve elektronike me Nr. Ref. 06/1-03/385-2016, të datës 14.07.2016, rezulton se ekspertimi NUK ËSHTË KRYER nga Agjencioni për Forenzikë i Kosovës, si organ i autorizuar nga Prokuroria Speciale për kryerjen e ekspertimit, por nga Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit, organ ky që hyn në organigramën e një tjetër institucioni shtetëror, pra Policisë së Kosovës dhe që NUK ËSHTË AUTORIZUAR asnjëherë nga Prokuroria për kryerjen e ekspertimit të pajisjeve të gjetura në NTSH "Tosi" dhe "AutoMarket" [...]“Agjencioni i Kosovës për Forenzikë dhe Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit, që operon pranë Policisë së Kosovës, JANË DY ORGANE TË NDRYSHME, me përgjegjësi të ndryshme dhe të ndara [...] Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizmit pranë Policisë së Kosovës NUK KA PASUR ASNJË AUTORIZIM për kryerjen e ekspertizës së pajisjeve elektronike”.*

131. Ndaj pretendimeve të lartpërmendura, Gjykata e Apelit ishte përgjigjur: “[...] Së, dyti as raporti njoftues-analizimi i ekzaminimeve të pajisjeve elektronike me nr. ref 06/1-03/385-2016 datë 14.07.2016 nuk është provë e papranueshme për faktin se ka mungesë substanciale të të dhënave të obligueshme të parashikuar me nenin 138 e 147 të KPP. Ngase, kjo provë është marrë konform dispozitave ligjore nenit 136 e 137 të KPP dhe nuk ka mungesë substanciale të të dhënave të obligueshme ashtu siç pretendohet është evidente se Prokurori me vendimin PPS.nr.39/2014 date 17.06.2016 ka kërkuar nga Agjencioni i Kosovar i Forenzikes Njësia për Teknologji Informative që kryejë ekspertimin e pajisjeve elektronike që i janë sekuestruar të akuzuarit, kurse këtë ekspertizë e ka kryer Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizimit. Mirëpo, ekzaminimi i pajisjeve elektronike nga ky sektor nuk e bën këtë provë materiale të papranueshme ashtu siç pretendon mbrojtësi, sepse, Sektori i Hetimeve të Drejtorisë kundër Terrorizimit ekzaminimin e pajisjeve elektronike e ka bërë me kërkesën e Prokurorit, kurse konform dispozitave ligjore respektivisht nenit 147 par.2 të KPP për pajisjet kompjuterike, pajisjet elektronike të ruajtjes apo pajisje të ngjashme që janë marrë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet urdhrorit të gjykatës ose me pëlqim, Prokurori i Shtetit mund të autorizoj zyrtarin e policisë apo ekspertin për të shqyrtuar, analizuar dhe kërkuar informata ose të dhëna që gjenden brenda pajisjeve kompjuterike, pajisjeve elektronike për ruajtje ose pajisjeve të ngjashme. Sipas par.4-të të njëjtit neni zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër nxjerr raport ekspertimit me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të kodit por edhe kushteve që parashihen me këtë paragraf (nën par. 4.1, 4.2,4.3, 4.4, 4.5 e 4.6), e që në fakt ne rastin konkret konform këtyre dispozitave edhe është vepruar” (shih, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. Nr. 100/2017, i 23 majit 2017, fq.5, rreshti 29).
132. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë administruar provën e kontestuar duke u bazuar në nenin 138 [Raporti i ekspertit] dhe nenin 147 (2) dhe (4) [Analiza kompjuterike] të KPP-së, çka përcakton se me urdhër apo pëlqim të gjykatës, prokurori i shtetit mund të autorizojë zyrtarin e policisë apo ekspertin për të shqyrtuar, analizuar dhe kërkuar për informata ose të dhëna që gjenden brenda pajisjeve kompjuterike, pajisjeve elektronike për ruajtje ose pajisjeve të ngjashme.
133. Gjykata konsideron se pretendimi për ekzaminim e pajisjeve elektronike-sidomos duke pasur parasysh përgjigjen e detajuar të Gjykatës së Apelit-përbën çështje të faktit dhe të ligjit çka është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta. Gjykata-bazuar në parimin e subsidiaritetit-nuk mund t’i zëvendësojë vendimet e veta me ato të gjykatave të rregullta.
134. Nga sa më sipër, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç nëse dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mundet vetë të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend se një tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së

katërt”, çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufijve të juridiksionit të saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin nr. KI13/16, cituar më lart).

135. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.

Pretendimi për shkelje të të drejtës së privatësisë

Parimet e përgjithshme nga jurisprudenca e GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën e privatësisë gjatë zbatimit të masave të vëzhgimit të fshehtë

136. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e masave të fshehta hyjnë në fushëveprimin e nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së.
137. Gjykata vëren se në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka konstatuar se masat e fshehta të vëzhgimit, duke përfshirë bisedat telefonike, janë të mbuluara me nocionet “jeta private” dhe “korrespondenca”, përbrenda kuptimit të nenit 8 të KEDNJ-së. GJEDNJ ka theksuar se “vëzhgimi” përbën ndërhyrje në ushtrimin e të drejtave të garantuara me nenin 8 të KEDNJ-së. Sipas paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së, ndërhyrja e tillë arsyetohet nëse është në “pajtim me ligjin”, “ndjek një apo më shumë qëllime legjitime të referuara në paragrafin 2” dhe është i “nevojshëm në një shoqëri demokratike”, në mënyrë që të arrihet qëllimi apo qëllimet (shih rastet e GJEDNJ-së *Kvasnica kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi 9 qeshorit 2009, paragrafi 77 dhe *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 janarit 2015).
138. Shprehja në “pajtim me ligjin” e nenit 8.2 të KEDNJ-së, së pari dhe përgjithësisht, kërkon që masa e fshehtë të jetë e bazuar në legjislacionin vendor; kjo i referohet po ashtu cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai të jetë i qasshëm për personin në fjalë, i cili, për më tepër, duhet të jetë në gjendje t'i parashikojë pasojat e ligjit ndaj tij, dhe të jetë në pajtim me sundimin e ligjit (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së *Kruslin v. France*, Aktgjykim i 24 prillit 1990, paragrafi 27).
139. Kriteri ligjor i “parashikueshmërisë” nuk mund të kuptohet se një individ duhet të jetë në gjendje të parashikojë se kur ka gjasë që autoritetet do të ndërhyjnë në komunikimet e tij, ashtu që ai ta përshtatë sjelljen e tij në përputhje me rrethanat. Megjithatë, në rastet kur autorizimi i ekzekutivit ushtrohet fshehtë, rreziku i arbitraritetit është i dukshëm. Prandaj, e drejta vendore duhet të jetë mjaftueshëm e qartë me dispozitat e saj për t'iu dhënë individëve indikatorë të mjaftueshëm lidhur me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të veshura me pushtet për t'u mbështetur në masa të tilla (shih rastin e GJEDNJ-së *Bykov kundër Rusisë* [DHM], Aktgjykimi i 10 marsit 2009, paragrafi 76).
140. Në këtë drejtim, GJEDNJ po ashtu ka theksuar nevojën për garanci procedurale. Posaçërisht, pasi që zbatimi në praktikë i masave të fshehta të vëzhgimit të

komunikimeve nuk është i hapur për shqyrtim nga individët e vëzhguar apo publiku në përgjithësi, do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit që diskrecioni i akorduar për ekzekutivin apo për gjyqësorin të shprehet në formë të “pushtetit të pa frenuar (*unfettered power*)” (shih vendimin e GJEDNJ në *rastin Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, 6 shtator 1978 dhe po ashtu shih *Blaj kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 8 prillit 2014, paragrafi nr. 118).

141. Rrjedhimisht, ligji duhet të përcaktojë fushëveprimin e diskrecionit që iu është dhënë autoriteteve kompetente, me qartësi të mjaftueshme për t'i dhënë individit mbrojtje ndaj ndërhyrjes arbitrare. Veç kësaj, duke pasur parasysh rrezikun që sistemi i vëzhgimit të fshehtë për mbrojtje të sigurisë shtetërore mund ta cenojë demokracinë, GJEDNJ duhet të sigurohet se garancitë kundër keqpërdorimit janë të mjaftueshme dhe efektive. Ky vlerësim varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç janë natyra, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e masave të mundshme, baza për t'i urdhëruar ato, autoritetet kompetente që i lejojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin ato, si dhe llojin e mjetit juridik kundër tyre që ofrohet nga e drejta vendore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 18 majit 2010, paragrafi 153).
142. Në praktikën e saj, GJEDNJ ka vënë në dukje se ajo duhet të përcaktojë nëse procedurat për urdhërimin dhe zbatimin e masave të fshehta që garantojnë vetëm “ndërhyrjen” përbrenda asaj që është e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”. Veç kësaj, vlerat e një shoqërie demokratike duhet respektuar besnikërisht, për aq sa është e mundur, në procedurat mbikëqyrëse, nëse kufijtë e domosdoshmërisë, brenda kuptimit të nenit 8.2 të KEDNJ-së, nuk do të tejkalohen (shih GJEDNJ, rasti *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 janarit 2015, paragrafët 78-84 dhe referencat e përmendura aty).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

143. Në dritën e praktikës së GJEDNJ-së, Gjykata duhet të vërtetojë nëse masa e vëzhgimit të fshehtë nga autoritetet publike ndaj të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, kalon testin e trefishtë: (i) nëse ndërhyrja ka qenë në pajtim me një “ligj” që ka qenë mjaftueshëm i qasshëm (*accessible*) dhe i parashikueshëm; (ii) nëse po, a ishte ai kufizim proporcional me qëllimin legjitim të listuar në paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së; dhe, (iii) nëse kufizimi është i “domosdoshëm në një shoqëri demokratike”.
144. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson pretendimin e parashtruesit të kërkesës se “Gjykata ka dështuar që të zbatojë *DETYRIMIN PROCEDURAL NGA NENI 88 i KPP, sepse NUK KA SHPJEGUAR ARSYET SI dhe PSE informacioni i siguruar përmes masës hetimore të fshehtë, ka gjasa që të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe PËRSE hetimi nuk mund të kryhej nëpërmjet mjeteve të tjera hetimore me pak invazive [...] kundërligjshmëria e Urdhëresave për autorizimin dhe zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, kanë rezultuar në shkeljen e të drejtës për privatësi, nga neni 36.3 i Kushtetutës së Republikës se*

Kosovës, si dhe inter alia neni 8 i KEDNJ, për shkak të dështimit të gjykatave për të arsyetuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave në fjalë [...]”.

145. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është trajtuar nga të gjitha shkallët gjyqësore të gjykatave të rregullta.
146. Kështu, Gjykata Themelore, lidhur me këtë çështje, kishte arsyetuar si në vijim: *“Trupi gjykues konstatoi se provat e siguruara në procedurë paraprake janë marrë dhe grumbulluar konform dispozitave të KPPK-së, të gjitha provat materiale janë nxjerrë në zbatim të urdhëresave të Gjykatës për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe në këtë mënyrë nuk janë prova të marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale të paraparë në nenin 257 par. 2 të KPPK-së, pra janë prova të pranueshme të propozuara në akuzën fillestare e pastaj edhe në akuzën e ndryshuar në bazë të nenit 252 të KPPK-së, të paraqitur nga prokurori [...]”* (shih Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, PKR-65/16, i 18 janarit 2017, faqe 17, rreshti 1).
147. Ndërsa Gjykata e Apelit kishte arsyetuar se *“të gjitha provat me numër rendor prej 3-11 (urdhëresat e Gjykatës lidhur me masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit gjatë hetimit paraprak) [...] janë marrë konform dispozitave ligjor të Kodit të Procedurës Penale dhe janë në pajtim me nenin 88 të KPP. Sipas dispozitës së nenit 97 par. 1 të KPP prova e marra nëpërmjet masës nga ky kapitull është e papranueshme nëse urdhri për zbatimin e masës së tillë është i kundërligjshëm, ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton qartë se asnjë nga urdhëresat për zbatimin e masave të tilla nuk janë të kundërligjshme madje as me ankesë nuk kundërshtohen në këtë drejtim. Pastaj gjykata ka dhënë arsye të qarta pse ka urdhëruar masat e tilla, prandaj edhe pretendimet se gjykata nuk i ka përpiluar ato konform dispozitës së nenit 88 të KPP nuk janë të bazuara”* (shih Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 100/2017, i i 23 majit 2017, fq.6, rreshti 3).
148. Gjykata përsëritë edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme se: *“Gjykata Supreme konstatojë se këto pretendime janë paraqitur edhe në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës dhe Gjykata e Apelit me rastin e marrjes së aktgjykimit të shkallës së dytë i ka vlerësuar këto pretendime dhe i ka refuzuar si të pabazuara, ndërsa kjo gjykatë gjeti se arsyet e dhëna në aktgjykimin e shkallës së dytë janë ligjore dhe të drejta dhe si të tilla i aprovoj. Në të njëjtën kohë konstatojë se nuk qëndrojnë të metat në aktgjykimin e shkallës së dytë të cilat në kërkesë pretendohen dhe se për shumicën e tyre janë dhënë arsye të detaizuara edhe në këtë aktgjykim”.*
149. Për sa më sipër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë arsyetuar masat e vëzhgimit të fshehtë duke u mbështetur kryesisht në dispozitat e neneve 88, 90, 252.5 dhe 257. 2 të KPP-së. Gjykata po ashtu vëren se neni 90 i KPP-së parashikon se urdhrat nga neni 88 i KPP mund të përdoren vetëm për hetimin, mes tjerash, të së paku një nga këto vepra të dyshuara penale: (i) fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste, në pajtim me nenin 141 të Kodit Penal; dhe,

- (ii) përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 143 të Kodit Penal.
150. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nga arsyetimi i gjykatave të rregullta, por edhe nga përmbajtja e kërkesës në tërësi, rezulton se: (i) masat e vëzhgimit të fshehtë kanë qenë të bazuara në ligj, i cili, ka qenë dhe është i qasshëm për parashtruesin e kërkesës, në mënyrë që ai ta përshtatë sjelljen e tij sipas rrethanave të rastit; dhe, (ii) masat në fjalë janë proporcionale dhe ndjekin qëllimin legjitim për parandalimin dhe gjykimin e veprave penale që kanë të bëjnë me terrorizmin, si kërcënim serioz i sigurisë publike; çka rezulton, se (iii), ato masa janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.
151. Në sfondin e luftës kundër terrorizmit, Gjykata e konsideron të nevojshme t'i referohet disa konstatimeve të GJEDNJ-së, në rastin *Fox, Campbell and Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, se: “[...] krimi i terrorizmit bie në një kategori të veçantë. Për shkak se shoqërohet me humbje të jetëve dhe vuajtje njerëzore, policia janë të obliguar të veprojnë me nguti maksimale në mbledhje të informatave përfshirë informatat nga burime të fshehta. Veç kësaj, policia shpesh mund të detyrohet ta arrestoj një terrorist të dyshuar bazuar në informata të besueshme por që nuk mund t'i zbulohen të dyshuarit ose të nxjerrën në gjykatë për ta mbështetur aktakuzën [...] duke pasur parasysh vështirësitë e qenësishme në hetimin dhe ndjekjen e krimeve të terrorizmit në Irlandën Veriore, “arsyeshmëria” që justifikon arrestimet e tilla nuk mund të gjithnjë të gjykohe bazuar në standardet e njëjta që zbatohen në luftimin e krimin të zakonshëm [...] Konventa nuk duhet të zbatohet në atë mënyrë që të vë në vështirësi jo proporcionale Palët Kontraktuese në marrjen e masave efektive për t’iu kundërvënë terrorizmit të organizuar” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Fox, Campbell and Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 30 gushtit 1990, paragrafët 32-34 dhe referencat e përmendura aty).
152. Gjykata konstaton se masat e vëzhgimit të fshehtë nuk kanë cenuar thelbin e të drejtave të garantuara me nenin 36.3 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së.
153. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.
Pretendimi për shkelje të parimit për mos dënim pa ligj - Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale
- Parimet të përgjithshme nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së lidhur me parimin e mosdënimit pa ligj*
154. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me nenin 139 të KPK-së hyjnë në fushëveprimin e nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenit 7 [Nuk ka dënim pa ligj] të KEDNJ-së.

155. Gjykata i referohet interpretimeve të përgjithshëm të GJEDNJ, që vënë në pah se në cilindo sistem juridik, sado i qartë që të jetë formulimi i një dispozite ligjore, duke përfshirë edhe dispozitat e të drejtës penale, është e pashmangshme të mos ketë nevojë për interpretim gjyqësor të tyre. Funkzioni që u besohet gjykatave, shërben pikërisht për t'i hequr ato dyshime që mund të mbeten për sa i përket interpretimit të normave juridike (shih vendimin e GJEDNJ, *Kafkaris kundër Qipros*, Aktgjyimi i vitit 2008, paragrafi 141).
156. Në traditën juridike të shteteve palë në KEDNJ, është qëndrim i përgjithshëm se jurisprudenca, si burim i së drejtës, jep kontribut të domosdoshëm në zhvillimin progresiv të së drejtës penale. Neni 7 i Konventës nuk mund të interpretohet sikur e ndalon sqarimin progresiv të rregullave të përgjegjësisë penale, përmes interpretimit gjyqësor nga njëra çështje në tjetrën. Kjo me kusht që rezultati i interpretimeve gjyqësore të jetë koherent me thelbin e veprës penale dhe i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme (*S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 36; *Streletz, Kessler e Krenz kundër Gjermanisë*, paragrafi 50; *Kononov kundër Letonisë*, paragrafi 185).
157. Parashikueshmëria e interpretimit gjyqësor ka të bëjë si me elementet përbërëse të veprës penale (*Pessino kundër Francës*, paragrafët 35-36; *Dragotoni u e Militaru-Pidhorni kundër Rumanisë*, paragrafët 43-47; *Dallas kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafët 72-77), e poashtu edhe me masën e zbatueshme të dënimit (*Alimuçaj kundër Shqipërisë*, paragrafët 154-162; *Del Rio Prada kundër Spanjës*, paragrafët 111-117).
158. Në qoftë se GJEDNJ konstaton se ka pasur mungesë parashikueshmërie të një veprë penale, asaj nuk i kërkohet më fare që të shqyrtojë nëse sanksioni i zbatuar ishte në vetvete i parashikuar nga ligji, në kuptimin e nenit 7. të KEDNJ (*Plechkov kundër Rumanisë*, paragrafi 75). Interpretimi i pikave thjesht procedurale nuk ka asnjë ndikim mbi parashikueshmërinë e veprës penale dhe nuk ngre, për rrjedhojë, asnjë pikëpyetje në këndvështrimin e nenit 7. të KEDNJ (*Khodorkovskiy e Lebedev kundër Rusisë*, paragrafët 788-790, lidhur me një pengesë të pretenduar procedurale që rëndonte mbi akuzën).
159. Për sa i përket pajtueshmërisë së interpretimit gjyqësor të dhënë nga juridiksionet e brendshme me thelbin e veprës penale, GJEDNJ duhet të verifikojë nëse ky interpretim ka qenë në përputhje me formulimin e dispozitës së ligjit penal në fjalë, të lexuar në kontekstin e saj, dhe nëse ai interpretim ka qenë i paarsyeshëm (shih, ndër të tjerë, *Jorgic kundër Gjermanisë*, paragrafët 104-108, lidhur me krimin e gjenocidit).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

160. Gjykata vë në spikamë pretendimin e parashtruesit të kërkesës: “Në paragrafët 102-119 të Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, Mbrojtja e z. Fatos RIZVANOLLI ka parashtruar shkëlqën e parimit të mosdënimit pa ligj [...] pikërisht sepse, edhe nën supozimin se vërtet z. Fatos RIZVANOLLI kishte kryer

veprimet më të cilat ngarkohej, të njëjtat nuk formësonin figurën e veprës penale për të cilën i njejtë u shpall fajtor dhe u dënua. Gjykata Supreme shmang plotësisht pretendimet e ngritura nga Mbrojtja [...] Neni 365.1, nënpar. 1.1 i KPP, parashikon në mënyre eksplicite që: Gjykata, në aktgjykimin me të cilin i akuzuarin e shpall fajtor shënon: 1.1. veprimin penale për të cilin shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal. Në pikat I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili pranohet në tërësi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, rezulton se Gjykata Themelore ka dështuar që të përfshijë në dispozitiv, FAKTET dhe RRETHANAT QË PËRBËJNË FIGURËN E VEPRËS PENALE, FAKTET dhe RRETHANAT nga të cilat varet zbatimi i nenit 139 të KPK, si dhe të tregojë SESI FAKTET DHE RRETHANAT E CITUARA, PËRBËJNË ELEMENTET KONSTITUTIVE TË VEPRËS PENALE Rekrutimi për terrorizëm, nga neni 139 i KPK, për të cilën është dënuar z. Fatos RIZVANOLLI, çka ka rezultuar në shkeljen e ligjit penal në dëm të tij, si dhe të vetë parimit të mosdënimit pa ligj, të sanksionuar nga neni 7 i KEDNJ”.

161. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore [Aktgjykimi PKR-65/16, 18 janar 2017], kishte theksuar, ndër të tjera, se: “[...] I pandehuri, gjatë intervalit kohorë të vitit 2011 – 2014 ka ofruar fonde dhe burime financiare në shfrytëzim të personave të pandehur dhe të dënuar për terrorizëm, si pjesë e organizatave terroriste ISIS dhed Al Nusra [...] duke vënë në dispozicion të tyre makinat e tij të tipit ‘Toyota’ model T22, ngjyrë Hiri, me targa 01-877-CF, për tani të dënunarit ShA dhe të dyshuarin tjetër SH me datën 17.10.2011, veturën “Ford”, ngjyrë të Gjëlbert, me targa 01-462-CQ, për tani të dënunarit ZQ me datën 04.10.2013, si dhe veturën “Volkswagen”, ngjyrë të Kaltër, me targa 01-407-EG, për të pandehurin E. B., me datë 07.10.2014 [...] Në muajin shtator të vitit 2013, sipas kërkesës së tani të dënuarit IB, i akuzuari Fatos Rizvanolli ka munëdsuar dërgimin e PB (AN– i cili më pas është vrarë në Siri) dhe ShK për udhëtim në Siri, më datë 05.10.2013, së bashku me HD dhe KM të vrarë në konfliktin në Siri, përfshirë këtu edhe vet IB, por ky i fundit kthehet-dëbohet nga autoritetet e shtetit turk të aeroportit më datë 06.10.2013 [...] më këtë ka kryer veprën penale në vazhdim dhe bashkëkryerje, rekrutim për terrorizëm nga neni 139 lidher me nenin 31 të KPRK-së”.
162. Gjykata vë në dukje se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kishin refuzuar ankesën, gjegjësisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PKR-65/16, 18 janar 2017].
163. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se interpretimi nga gjykatat e rregullta të dispozitave përkatëse të KPK-së: (i) nuk rezulton të jetë lexuar jashtë kontekstit të dispozitave në fjalë, apo se ka qenë i paarsyeshëm dhe arbitrar; dhe, (ii) gjykatat e rregullta kanë sqaruar përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës, bazuar në dispozitën e nenit 139 të KPK-së. Prandaj, intepretimi i gjykatave të rregullta rezulton të jetë koherent me thelbin e veprës penale dhe i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme.

164. Gjykata sërish i referohet dispozitës së nenit 139 [Rekrutimi për terrorizëm] i Kodit Penal që parashikon se: “*Kushdo që i bën thirrje personit tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, të marrë pjesë në aktivitetet e grupit terrorist apo të sigurojë fonde ose burime materiale, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet*”.
165. Gjykata konsideron se interpretimi i dispozitave përkatëse të KPK-së, duke përfshirë nenin 139, nga gjykatat e rregullta nuk ka cenuar thelbin e të drejtës të garantuar me nenin 33.1 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 [Nuk ka dënim pa ligj] të KEDNJ-së.
166. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.
167. Në fund, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar, mjete efektive juridike dhe shkelje të parimit *in dubio pro reo*, Gjykata konsideron se pretendimet në fjalë nuk ka nevojë të shqyrtohen sepse nuk ngrenë ndonjë çështje të re që nuk është shqyrtuar më parë në kuadër të neneve 31.4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] dhe 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. par. 1. dhe 3 (d) [E drejta për një proces të rregullt], 7 [Nuk ka dënim pa ligj] dhe 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47. 2 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (2), 58 (4) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 shtator 2020, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari që përgatiti vendimin

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Laban Radomir

Radomir Laban



Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi